



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Durrës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Goma per Automjete”.**

**NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 84858-05-08-2026**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

34350000-5; 34352000-9; 34352100-0

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,583,000 (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH.**

**Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlllogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...*Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...*”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdëklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar ne nenin 43 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kerkesat per kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa ne piken 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa ne piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference është bere që t’i shërbejnë

autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:**

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, i cili rregullon kriteret për procedurat e hapura të thjeshtuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që përvoja e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi, me qëllim garantimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që zotërojnë kapacitetin teknik dhe përvojën e nevojshme për realizimin e saj. Njëkohësisht, kjo kërkesë nuk tejkalon nivelin e nevojshëm dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi është vendosur brenda marzheve të lejuara nga legjislacioni përkatës dhe u jep mundësi pjesëmarrjeje një game të gjerë operatorësh ekonomikë. Në këtë mënyrë, kriteri për kontrata të ngjashme shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë teknike të operatorëve ekonomikë, duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe efektiv.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e percaktuara të AK-ve.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të **paktën 1(një)** automjet per transportin e mallrave, të cilin duhet t’i ketë në pronësi, me qira ose ne huapërdorje.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/huapërdorim

**Shenim 3.1:** Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarrsesit, huadhenesit dhe huapërdoresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

*Ky kriter quhet i përmbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, dhe në bazë të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”.*

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për përmbushjen e kontratës.

Kërkesa për këto mjete dhe pajisje është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, konkretisht me nevojën për transportin dhe shpërndarjen e materialeve të pastrimit në adresat e autoriteteve kontraktore, duke garantuar realizimin korrekt dhe në kohë të shërbimit. Në këtë mënyrë, përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) në fazën e ofertimit lehtëson pjesëmarrjen dhe redukton barrën administrative për operatorët ekonomikë, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumenteve provuese në fazën e vlerësimit përfundimtar siguron verifikimin e plotë të kapaciteteve të deklaruara, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, në përputhje me nenin 26, pika 1 dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor pranon si

provë paraprake vetëdeklarimin e operatorit ekonomik në vend të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike apo palë të treta. Pra, operatorët ekonomikë, në momentin e paraqitjes së ofertës, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), duke deklaruar përmbushjen e kriterëve të kërkuara, përfshirë edhe disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari paraqitjen e dokumenteve provuese që vërtetojnë saktësinë e vetëdeklarimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të ofertës, të dorëzuar në rrugë elektronike.

4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE Deklaratë në të cilën të marrë përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike duke cilësuar Inedexet e shpejtesise, peshes, vitin si dhe realizimin e afatit 10 ditor të levrimit të mallit objekt prokurimi.

**Argumentim:** Në bazë të nenit 36 në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kërkesave dhe specifikimeve.

Afati 10 ditor për levrimin e mallit objekt prokurimi kërkohej sepse gomat e automjeteve të AK janë tejet të amortizuara. Të ndodhur në këto kushte kërkohej të ndrohen të gjithë gomat e automjeteve.

5. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë Certifikatat ISO Si më poshtë:

5.1 Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikatë Personale ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, të perkthyer dhe noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Në Çertifikatë personale ISO 9001:2015 duhet të jetë e përfshirë Objekti i prokurimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime

ne ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i çertifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit. Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoriteteve në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

**5.2** Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate Personale ISO 14001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të sistemit të mbrojtjes së ambientit/mjedisit, të cilat do të garantonin mbrojtjen ndaj mjedisit, e përthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e leshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Ne Çertifikate personale ISO 14001:2015 duhet të jetë e përfshirë Objekti i prokurimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa që Operatori Ekonomik (OE) të disponojë certifikatë ISO 14001:2015 (të vlefshme) ose ekuivalente me të, është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5, gërma “a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kjo kërkesë synon të garantojë që Operatori Ekonomik disponon dhe zbaton një sistem të strukturuar të menaxhimit të mjedisit, duke siguruar që aktiviteti i tij zhvillohet në përputhje me standardet për mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndikimeve negative mjedisore. Certifikimi sipas standardit ISO 14001:2015 përfaqëson një konfirmim zyrtar se subjekti ekonomik

identifikon, vlerëson dhe menaxhon në mënyrë të vazhdueshme aspektet mjedisore të aktivitetit të tij, duke treguar angazhim për përmirësim të performancës mjedisore, respektim të legjislacionit në fuqi dhe parandalim të ndotjes. Zbatimi i këtij standardi rrit besueshmërinë e operatorit ekonomik ndaj autoritetit kontraktor dhe palëve të treta, si dhe kontribuon në përdorimin më efikas të burimeve natyrore, reduktimin e mbetjeve dhe uljen e rreziqeve mjedisore. ISO 14001:2015 është një standard ndërkombëtar i njohur gjerësisht, i zbatueshëm për çdo organizatë pavarësisht madhësisë apo fushës së aktivitetit, dhe garanton që operatori ekonomik operon në përputhje me praktikat më të mira për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

6. Operatori ekonomik ofertues, ne ditën e hapjes se ofertave (perpara hapjes se tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, prane NSHK Durres , duhet të paraqesë të protokolluara nje moster për secilin ze te mallrave objekt prokurimi, sipas listes se kerkuar:

**6.1Tabela:**

Nr	Emërtimi	Indeksi peshes	Indeksi shpejtesise	Njesia	Sasia
1	Goma 9,5R17,5 C	120/127	M	Cope	1
2	Goma 205/70 R15 C	106/104	H	Cope	1
3	Goma 195/75 R16 C	110/108	H	Cope	1
4	Goma 8,5 R 17,5	121/120	M	Cope	1
5	Goma 315/80 R 22,5 TL	156/154	M	Cope	2
6	Goma 13 R 22,5 TL	156/150	K	Cope	1
7	Goma 440/80R28 (16,9R28 TL)	156/156	A2	Cope	1
8	Goma 195/ R 14C	106/104	R	Cope	1
9	Goma 12,5/80 R18 (340/80 R18) TL	143	A8	Cope	1
10	Goma 10 R 22,5 TL	144/142	M	Cope	1
11	Goma 155/70R12	86/84	R	Cope	1
12	Goma 205/75 R17,5	124/122	M	Cope	1
13	Goma 215/75 R17.5	126/124	M	Cope	1
14	Goma 225/75 R16	104	H M+S	Cope	1
15	Goma 205/55 R 16	91	H	Cope	1
16	Goma 215/55 R16	93	VM+S	Cope	1

**Shenim:** Per gomen ne Tabele me nr. rendor 5 perkatesisht (Goma 315/80 R 22,5 TL) sipas specifikimeve te paraqitura, duhet te paraqiten si me poshte:

- 1 gome duhet gome diferenciali ( goma duhet te jete me lule ne forme kubike)
- 1 gome duhet gome e pare (goma duhet te jete me kanale te drejta)

**6.2.**Mostrat e kerkuara duhet te jene te paisura me etikete ne menyre qe te dallohet qarte marka, numri i gomes, indexset e shpejtesise dhe peshes si dhe viti i prodhimit.Te dhenat e etiketes duhet te jene ne perputhshmeri me te dhenat e gomes.

**6.3.** Mostrat duhet te shoqerohen me listen e gomave te paraqitura ku te jene shenuar te gjithë te dhenat, sasia dhe specifikimet.

**6.4** Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe te kryeje analizat e nevojshme laboratorike nese do te shihet e arsyeshme.

*Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedures.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 16/2024, si dhe në nenin 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejte me nevojën për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të gomave të ofruara nga operatorët ekonomikë, me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në zbatim të legjislacionit në fuqi, autoriteti kontraktor ka të drejtën të kërkojë mostra për të kryer verifikime konkrete mbi produktet objekt prokurimi, me qëllim garantimin e cilësisë dhe përmbushjen e standardeve të kërkuara.

Komisioni i Prokurimit Publik ka theksuar se, përveç kriterëve të kapacitetit teknik, autoriteti kontraktor mund të vendosë edhe kërkesa të tjera që lidhen me vërtetimin e përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, përfshirë dorëzimin e mostrave, si një mjet efektiv për vlerësim objektiv.

Në rastin konkret, kërkesa për mostra është e lidhur ngushtë me natyrën e produkteve që prokurohen, konkretisht gomat, të cilat përbëjnë element kyç për sigurinë dhe performancën e mjeteve. Verifikimi i gomave vetëm nëpërmjet katalogëve apo dokumentacionit teknik nuk është i mjaftueshëm, pasi këto burime nuk garantojnë gjithmonë një pasqyrim të saktë të karakteristikave reale të produktit që do të furnizohet. Për këtë arsye, paraqitja e mostrave mundëson një vlerësim të drejtpërdrejtë dhe konkret të cilësisë së materialit, strukturës së gomës, qëndrueshmërisë ndaj konsumit, kapjes në rrugë, si dhe përputhshmërisë me standardet e sigurisë. Mostrat shërbejnë për të verifikuar elementë thelbësorë si rezistenca ndaj konsumit, performanca në kushte të ndryshme rrugore dhe klimatike, cilësia e përbërjes dhe përputhshmëria me parametrat teknikë të kërkuar, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e përdorimit dhe jetëgjatësinë e produktit.

Sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e mostrave nuk përbën një kufizim të konkurrencës, por një mjet të domosdoshëm dhe proporcional për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve të prokuruar, në përputhje me parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.

## **Shtojca 6.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*

*a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efijencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*

*b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*

*c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

**Skicimet, parametrat teknik etj:**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Indexi peshes</b>	<b>Indexi shpejtesise</b>
1	Goma 9,5R17,5 C	120/127	M
2	Goma 205/70 R15 C	106/104	H
3	Goma 195/75 R16 C	110/108	H
4	Goma 8,5 R 17,5	121/120	M
5	Goma 315/80 R 22,5 TL	156/154	M
6	Goma 13 R 22,5 TL	156/150	K
7	Goma 440/80R28 (16,9R28 TL)	156/156	A2
8	Goma 195/ R 14C	106/104	R
9	Goma 12,5/80 R18 (340/80 R18) TL	143	A8

10	Goma 10 R 22,5 TL	144/142	M
11	Goma 155/70R12	86/84	R
12	Goma 205/75 R17,5	124/122	M
13	Goma 215/75 R17.5	126/124	M
14	Goma 225/75 R16	104	H M+S
15	Goma 205/55 R 16	91	H
16	Goma 215/55 R16	93	VM+S

### **Specifikimi i Materialeve:**

1. Gomat nuk duhet te jene te riveshura.
2. Gomat duhet te kene te indeksuar marken dhe vendin e prodhimit.
3. Gomat duhet te perdoren ne çdo stine.
4. Sasia e nje numri gome duhet te jene te se njejtës marke prodhimi.
5. Operatori ekonomik duhet te kete ne objektin e aktivitetit (QKB) te drejte per shitje/sherbim gomash.
6. Gomat duhet te jene prodhim sipas standartit nderkombetar ISO 9001-2015 ose standart ISO me i avancuar.
7. Garancia e gomave te automjeteve jo me pak se 55.000 km.
8. Garancia e gomave te jete jo me pak se 12 muaj nga lidhja e kontrates.
9. Gomat duhet te jene Marke e regjistruar.
10. Gomat duhet te jene standarti CE.
11. Ne trupin e gomes duhet te dallohet qarte numri i gomes, indexi i peshes , indexi i shpejtesise, java viti i prodhimit si dhe markimi CE.
12. Gomat duhet te jene prodhim jo me perpara se 12 muaj nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Per gomen ne Tabele me nr. rendor 5 perkatesisht (Goma 315/80 R 22,5 TL) sipas specifikimeve te paraqitura, duhet te jene te ndara si me poshte:

- gome diferenciali (goma duhet te jete me lule ne forme kubike)

- gome e pare (goma duhet te jete me kanale te drejta)

Sasia e gomave për diferencial dhe e gomave të para do të përcaktohet para lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues, në përputhje me nevojat konkrete të autoritetit kontraktor.

- Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lëvrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit.

- Malli do te dorezohet ne prani te komisionit te marrjes ne dorezim ne Magazinen e NSHK Durres.

- Afati i furnizimit do të jete 10 dite nga nenshkimi i kontrates.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet Teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

Argumentim Teknik: Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar parimet e

transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato janë konceptuar duke përshkruar minimumin e kërkesave të nevojshme teknike dhe funksionale që duhet të përmbushin mallrat, me qëllim garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe performancës së tyre në përdorim.

Përcaktimi i këtyre kërkesave është bërë në mënyrë të argumentuar, duke u bazuar në nevojat konkrete të autoritetit kontraktor dhe në natyrën e veprimtarisë së tij në fushën e shërbimeve të pastrimit, ku përdorimi i veglave cilësore dhe funksionale është thelbësor për realizimin efektiv të shërbimit. Në këtë kuadër, kërkesat teknike janë orientuar drejt sigurimit të produkteve të përshtatshme për përdorim të përditshëm dhe intensiv, me materiale rezistente ndaj konsumimit, funksionalitet të lartë dhe ergonomi, duke garantuar njëkohësisht edhe sigurinë e punonjësve gjatë përdorimit. Çdo kërkesë e përcaktuar në specifikimet teknike lidhet drejtpërdrejt me funksionin që duhet të kryejë produkti dhe nuk tejkalon nivelin e nevojshëm për realizimin e qëllimit të kontratës, në respektim të parimit të proporcionalitetit. Njëkohësisht, specifikimet janë hartuar në mënyrë të tillë që të mos kufizojnë konkurrencën, pasi nuk përmbajnë referenca ndaj markave tregtare, prodhuesve të caktuar, origjinës apo proceseve specifike të prodhimit.

Në rastet kur janë përdorur standarde teknike, ato janë shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, duke garantuar mundësinë për pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe ofrimin e produkteve alternative që përmbushin të njëjtin nivel cilësie dhe performance. Në këtë mënyrë, specifikimet teknike shërbejnë si një instrument i domosdoshëm për garantimin e një procesi prokurimi efektiv dhe të drejtë, duke siguruar përmbushjen e nevojave të autoritetit kontraktor pa cenuar parimet bazë të konkurrencës së lirë.